




Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



UDHËZUES

PËR TRAJNIMIN E TRAJNERËVE
MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE
NJERËZORE

PËR GJYQTARË DHE PROKURORË



UDHËZUES

PËR TRAJNIMIN E TRAJNERËVE MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

PËR GJYQTARË DHE PROKURORË

@ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Autor: David Mancini, Prokuror, Prokuroria e Aquilla-s, Itali

Redaktimi ligjor: Prof. Dr. Evis Alimehmeti

Juliana Rexha,
Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Përktheu: Gentjan Suli


ISBN: 9789928340863

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadrin e Programit “Avancimi i kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, i cili zbatohet me mbështetjen e Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

Ky dokument u financua nga qeveritë e sipër përmendura, gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
1. Nevojat për trajnim.....	9
1.1 Niveli i ndryshëm i njohurive të pjesëmarrësve në trajnim	10
2. Cilat duhet të jenë objektivat e një trajnimi?	11
3. Programi i trajnimit - Si të trajnojmë? Përmbajtja dhe metodologjia.....	12
4. Prezantimi i qëllimeve të udhëzuesit për Trajnimin e Trajnuesve.....	13
5. Modulet e trajnimit të trajnerëve.....	14
5.1 Moduli i parë - Informacion i përgjithshëm mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore.....	14
5.2 Moduli i dytë - Viktima dhe format e shfrytëzimit	15
5.3 Moduli i tretë - Hetimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave të rënda të shfrytëzimit	16
6. Ushtrimet e bazuara në simulim (mundësi që ofron fleksibilitet).....	21
6.1 Objektiva specifike për prokurorët.....	24
Shtojca 1 – Shembull i skenarit të një Ushtrimi Simulues	26





HYRJE

Ky Udhëzues, bashkë me “Manualin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë ligjorë – Trafikimi i Qenieve Njerëzore” dhe Manualin mbi Gjyqin Imitues, të botuara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri përgjatë periudhës 2022-2023, sjell një paketë të zgjeruar trajnimi për profesionistët e drejtësisë mbi temën e trafikimit.

Hartimi i një Udhëzuesi për Trajnimin e Trajnerëve synon ofrimin e një informacioni të thelluar për gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë, të specializuar ose jo në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, me qëllim planifikimin dhe zbatimin e planeve mësimore apo trajnimeve mbi hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Prej vitesh Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Shkolla e Magjistraturës po bashkëpunojnë për përditësimin e materialeve trajnuese mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe sjelljen e metodologjive të reja të trajnimit, të bazuara në metoda mësimdhënieje ku në qendër është pjesëmarrësi, siç janë trajnimi simulues apo gjyqi imitues. Nisur nga praktika pozitive e zhvillimit të këtyre metodave trajnuese, Prezenca e OSBE-së

ofron këtë Udhëzues Trajnimi për Trajnerë, i cili mund të përdoret nga stafi akademik i Shkollës së Magjistraturës për planifikimin dhe zhvillimin e trajnimeve interaktive me qendër pjesëmarrësin përta i përket tematikës së trafikimit të qenieve njerëzore. Ky Udhëzues, bashkë me “Manualin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë ligjorë – Trafikimi i Qenieve Njerëzore” dhe Manualin mbi Gjyqin Imitues, të botuara nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri përgjatë periudhës 2022-2023, sjell një paketë të zgjeruar trajnimi për profesionistët e drejtësisë mbi temën e trafikimit.

Risia e Udhëzuesit për Trajnimin e Trajnerëve është përqendrimi tek qasja ndërdisiplinore që duhet të trajtojë çdo trajnim mbi trafikimin e qenieve njerëzore, si në strukturë, përmbajtje ashtu edhe metodologji në kuadër të sfidave me të cilat përballen magjistratët shqiptarë në veprat

e trafikimit të qenieve njerëzore, për të pasur një nivel më të lartë ndërgjegjësimit dhe njohjeje të aspekteve të së drejtës penale të fenomenit. Ky material sjell çështjet kryesore që duhet të përmbajë një plan mësimor gjithëpërfshirës, apo një kurs i zgjeruar trajnimi për profesionistët e drejtësisë në fushën e trafikimit të personave. Nisur nga trajtimi i zgjeruar i temës së trafikimit në “Manualin për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë ligjorë – Trafikimi i Qenieve Njerëzore” të botuar nga OSBE në vitin 2022, ky material përqendrohet kryesisht në objektivat dhe mënyrën e trajtimit të tematikave të trajtuara në Manualin e lartpërmendur.

Ky Udhëzues hartohet mbi supozimin se trafikimi i qenieve njerëzore dhe format e ndryshme të shfrytëzimit janë në ndryshim të vazhdueshëm dhe

prokurorët e gjyqtarët (dhe trajnuesit e tyre) kanë nevojë të vazhdueshme për materiale informuese që shërbejnë për drejtim dhe mbështetje me efekt të menjëhershëm por njëkohësisht të qëndrueshme. E parë në këtë këndvështrim, një proces i zakonshëm mësimor apo plan trajnimi i Shkollës së Magjistraturës si për trajnimin fillestar ashtu edhe për atë të vazhdueshëm, mund të ndërtohet në bazë të një analize të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, metodologjie të qartë dhe ndërvepruese, të ketë përmbajtje të përditësuar, si dhe të trajtojë fenomenin e trafikimit nga pikëpamja e përfshirjes së disa agjencive dhe sektorëve.



1. NEVOJAT PËR TRAJNIM

Trafikimi i qenieve njerëzore njihet si një fenomen që ndryshon formë dhe qëllimet e shfrytëzimit që mund të jenë të lidhura jo vetëm me shërbimet seksuale të detyruara. Shfrytëzimi mund të përfshijë forma të tjera të shfrytëzimit dhe nënshtrimit me forcë, të tilla si puna e detyruar, skllavëria për shkak të borxhit,

shërbime të detyruara në shtëpi, puna e detyruar e fëmijëve, shfrytëzimi për veprimtari kriminale, martesë e detyruar, apo heqja e organeve. Për këtë arsye, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis formave të ndryshme të shfrytëzimit dhe këto forma të studiohen nëpërmjet trajnimeve për studentët e magistraturës dhe profesionistët e drejtësisë.

Përfituesit e këtij Udhëzuesi janë prokurorë dhe gjyqtarë por në vijueshmëri të procesit ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin bashkëpunues të agjencive të ndryshme që angazhohen që në fazën e identifikimit të viktimës, referimit tek shërbimet mbështetëse, veprimet për mbrojtjen e tyre, e që mund të shërbejnë si trajnerë në kuadër të funksioneve të tyre (si “profesionistë të tjerë ligjorë” dhe/ose punonjës socialë ose zyrtarë të tjerë publikë).

Është shumë e rëndësishme që, për trajtimin e dukurive të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore dhe dinamikat sociale që mbështesin origjinën dhe rritjen e tij, profesionistët e drejtësisë në Shqipëri të pajisen me njohuritë e duhura për t'u përballur me këto sfida. Këtu mund të përfshihen fusha që shtrihen nga e drejta migratore deri tek njohja me mekanizmat apo procedurat që lidhen me masat e ndryshme ndërinstitucionale për adresimin e trafikimit. Vlerësimi i nevojave për trajnim bëhet duke theksuar sfidat kryesore dhe vështirësitë e regjistruara deri më tani në sistemin gjyqësor, me qëllim që Udhëzuesi i Trajnimit të Trajnerëve dhe nevojat e pjesëmarrësve në trajnim të jenë gjithmonë të përditësuara.

Përfituesit e këtij Udhëzuesi janë prokurorë dhe gjyqtarë por në vijueshmëri të procesit ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin bashkëpunues të agjencive të ndryshme që angazhohen që në fazën e identifikimit të viktimës, referimit tek shërbimet mbështetëse, veprimet për mbrojtjen e tyre, e që mund të shërbejnë si trajnerë në kuadër të funksioneve të tyre (si “profesionistë të tjerë ligjorë” dhe/ose punonjës socialë ose zyrtarë të tjerë publikë). Agjenci të tilla mund të përfshijnë strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes së viktimës (i rritur dhe/ose i mitur), policinë e kufirit dhe migracionit, oficerët e policisë që hetojnë trafiket e paligjshme, strukturat sociale, inspektoratin e punës, kujdesin shëndetësor, bashkitë, OJF-të, apo punonjësit e policimit në komunitet.



1.1 NIVELI I NDRYSHËM I NJOHURIVE TË PJESËMARRËSVE NË TRAJNIM

Nevojat mund të jenë të ndryshme në varësi të programeve të mësimdhënies, pjesë e planeve të formimit fillestar apo atij vazhdues, apo edhe brenda vetë planit të formimit fillestar në varësi nga viti i studimit. Ndonëse niveli i njohurisë dhe përvojës ndryshon natyrshëm në varësi të llojit dhe vitit të studimit, metodologjia e sugjeruar përgjatë procesit të plotë të trajnimit mund të mbetet e njëjtë, sepse nevojat dhe pritshmëritë e gjyqtarëve

dhe prokurorëve duhet të përcaktohen sipas aktualitetit të trafikimit të qenieve njerëzore, profilit të viktimave të trafikimit dhe mënyrës më efektive për zbulimin e krimit të organizuar. Kështu, mund të ndryshohet e të përshtatet niveli i thellimit në temat përkatëse, por jo prioritetet dhe procesi i të nxënimit. Prandaj, propozimi i mëposhtëm mund të përshtatet për çdo grup dhe nivel profesionistësh sipas njohurive që kanë.



2. CILAT DUHET TË JENË OBJEKTIVAT E NJË TRAJNIMI?

Një plan mësimor ose trajnim në fushën e trafikimit duhet të orientohet drejt objektivave që synojnë rritjen domethënëse të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve jo vetëm në përgjithësi, por edhe në lidhje me temën konkrete të trafikimit të qenieve njerëzore.

Më poshtë jepet një listë e shkurtër por jo shteruese e objektivave që mund të përmbajë një trajnim për studentë magistratë (formimi fillestar) dhe gjyqtarë e prokurorë (formimi vazhdues):

Pasqyrë krahasimore e legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (TQNj);

Metodat e hetimit të menjëhershëm dhe të plotë;

Qasje me në qendër të drejtat e njeriut në hetimet për TQNj;

Kujdesi për të siguruar asistencë dhe mbrojtje për viktimat pa u kushtëzuar nga bashkëpunimi i tyre me strukturat ligjzbatuese;

Marrja e provave në respekt të kërkesave të ligjit;

Mbajtja parasysht e rëndësisë së qasjes gjithëpërfshirëse të agjencive;

Hetim i gjerë dhe proaktiv (financiar, digjital, policia shkencore...);

Paraqitja e provave gjatë procedimit të çështjeve TQNj;

Mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve në gjykatë (para, gjatë dhe pas procesit);

Ushtrimi i së drejtës së viktimës për kompensim;

Kërkesat e një procesi të drejtë gjyqësor;

Të tjera tema për t'u përcaktuar në vazhdimësi;



3. PROGRAMI I TRAJNIMIT: SI TË TRAJNOJMË? PËRMBAJTJA DHE METODOLOGJIA.

Përmbytja e Trajnimit të Trajnerëve është e ngjashme me një trajnim shumëdisiplinar. Megjithatë, Trajnimi i Trajnerëve ka një komponent specifik në lidhje me parimet, metodologjinë dhe instrumentet e trajnimit pasi duhet të konceptohet në mënyrë të tillë që t'i përgatisë pjesëmarrësit të ofrojnë trajnime për këtë temë për profesionistët brenda agjencive të tyre ose brenda një konteksti me përfshirjen e shumë agjencive. Kështu, në Trajnimin e Trajnerëve, rëndësi thelbësore ka tema “si të trajnojmë”.

Parimi “si të trajnojmë” dhe metodat e tij mund të përdoren në mënyrë efektive gjatë gjithë programit të trajnimit dhe mund të diskutohet në lidhje me përmbytjen e secilit takim apo sesion trajnimi.

Në lidhje me sesionet individuale, pjesëmarrësit - trajnues të ardhshëm - duhet të ndjekin një rrugë kognitive dhe metakognitive, duke pyetur vazhdimisht veten nëse procesi mësimor është i efektshëm, çfarë mund të përmirësohet, dhe nëse trajnimi i propozuar, në të njëjtat kushte, mund të jetë me përfitim për pjesëmarrës të tjerë.


Metodologjia e trajnimit përfshin një ndërthurje metodash dhe instrumentesh të ndryshme të hartuara për të pasur një qasje angazhuese dhe pjesëmarrëse, përfshirë prezantime me mjete

të ndryshme, sesione teorike, diskutime në grupe të vogla dhe në grup të madh me të gjithë pjesëmarrësit, punë në grupe, raste studimore, role/simulime, etj.

Metodat më interaktive të trajnimit mbështeten te studimi i rasteve, simulimet, gjyqi imitues. Rastet studimore duhet të jenë të larmishme në përputhje me sesionet individuale, nevojat specifike dhe nivelin e njohurive të pjesëmarrësve. Në thelb, ato duhet të përfshijnë një sintezë të rasteve reale në vend apo edhe të huaja (në varësi të vendimeve ose urdhërave të gjykatës) të cilat duhet të studiohen, diskutohen, edhe në drejtim të temës bazë me të cilën lidhen (p.sh. identifikimi, mbrojtja dhe intervistimi i viktimës, teknikat e hetimit, analiza e rregullave penale që zbatohen për rastin, dhe të tjera).

Trajnimet simuluese do të shpjegohen më në hollësi në vijim të këtij materiali, sikurse edhe gjyqet imituese, duke u kufizuar në fazat specifike të procesit gjyqësor.

Kohëzgjatja e secilit seminar trajnimi mund të jetë nga një deri në tre ditë sipas programeve akademike dhe kohës në dispozicion; rrjedhimisht, metodologjia dhe teknikat mund të shkurtohen ose të zgjaten.



4. PREZANTIMI I QËLLIMEVE TË UDHËZUESIT PËR TRAJNIMIN E TRAJNUESVE.

Siç u përmend më lart, një pikë e fortë reference është edhe **Manuali për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Profesionalistë të tjerë Ligjorë i OSBE-së**.¹ Për shembull, ai është marrë si referencë për metodologjinë e të mësuarit në organizimin e seminareve të ndryshëm të trajnimit për gjyqtarë

dhe prokurorë. Megjithatë, edhe nëse përfituesi kryesor i trajnimit do të jetë gjyqësori, pjesëmarrja/bashkëpunimi i profesionalistëve të ndryshëm duhet të parashikohet si mundësi në përputhje me karakteristikat shumëdimensionale të fenomenit



5. MODULET E TRAJNIMIT TË TRAJNERËVE

5.1 MODULI I PARË



Informacion i përgjithshëm mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore
(referencë në kapitullin 1 të Manualit).

a. Zhvillimet më të fundit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; dallimi dhe kufijtë me fusha të tjera (migracioni - mbrojtja ndërkombëtare - çështjet gjinore - ekonomitë e paligjshme). Dimensioi modern i trafikimit (trafikimi i qenieve njerëzore dhe skllavëria moderne); një vizion në nivel ndërkombëtar dhe rajonal nga

një pikëpamje globale si edhe e fenomenit. Në thelb, kërkon një kuptim gjeopolitik/ekonomik/social/antropologjik si parakusht për kalimin të një analizë ligjore. Hyrja prezantuese mund të ketë një natyrë të përgjithshme, por më pas duhet të priret të fokusohet në skenarë konkretë e të prekshëm në nivel kombëtar.

¹ <https://www.osce.org/presence-in-albania/512641>

- b. Në këtë kuptim, lehtësohet kalimi tek shqyrtimi i burimeve të së drejtës ndërkombëtare (OKB, KiE, OSBE) duke prekur në këtë mënyrë aspektet e trajtuara nga kapitujt 2 dhe 3 të Manualit. Nevojitet të bëhet një analizë e legjislacionit penal për trafikimin dhe veprave të lidhura me të (duke nisur nga nenet 110(a) dhe 128(b) të Kodit Penal Shqiptar). Veprimet, mjetet, dhe qëllimet e shfrytëzimit, konkretisht elementet themelore të veprës duhet të zotërohen dhe të zbatohen nga ana e profesionistëve të drejtësisë.
- c. Për ta plotësuar tablonë, do të ishte e dobishme

të ofrohej një shpjegim mbi detyrimet pozitive të Shteteve (duke shtjelluar dhe përgjegjësitë që kanë institucionet përkatëse në këtë drejtim). Më pas, një sesion tejet i rëndësishëm lidhet me studimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përcaktimi i detyrimeve pozitive të Shteteve, fushave të ndryshme të praktikës për të cilat janë dhënë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasojave të mundshme në nivel kombëtar për punën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve vlen si shtyllë në procesin e trajnimit të trajnuesve.



Metodologjia:

(sesione teorike - video - raste studimore - diskutime në grup në fund të seancës së trajnimit)

5.2 MODULI I DYTË



Viktima dhe format e shfrytëzimit

(shih referencat në Manual, kapitujt 5 dhe 7)

- a. Një fushë e dytë trajnimi mund të fokusohet tek viktima. Së pari, duhet të përcaktohen karakteristikat viktimologjike në përgjithësi dhe më pas në lidhje me raste të ndryshme të mundshme dhe forma të ndryshme shfrytëzimi (seksual, veprimtari kriminale, lypje e detyruar) si dhe me specifikën e trafikimit të fëmijëve. Qasja e parë e temës së viktimës së trafikimit mund t'i kushtohet përparësisë së një identifikimi të hershëm, asistencës dhe mbrojtjes sipas standardeve rregullatore të parashikuara në kuadrin ndërkombëtar si dhe duke iu referuar kontekstit kombëtar. Cilat janë veprimet që duhen zbatuar nga disa agjenci; çfarë zhvillimesh ka në kuadrin e një

Mekanizmi Kombëtar Referimi për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit si dhe në Procedurat Standarde të Veprimit në fuqi, apo dhe në dritën e Planit Kombëtar të Veprimit 2021-2023 në Shqipëri.

Në të vërtetë, ky studim i thelluar duhet të shihet nën dritën e situatës specifike të trafikimit në vend, ku është e qartë se cili është roli i gjyqtarit dhe prokurorit. Pjesëmarrësit në trajnim duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të vlerësojnë më mirë faktet dhe të përmbushin me përpikëri rolin e tyre në fazat e mëpasshme në nivel ndjekjeje penale dhe gjykimi.



Metodologjia:

(sesione teorike - video - raste studimore - diskutime në grup në fund të seancës së trajnimit)

Viktima duhet të vazhdojë të luajë një rol qendror në trajnim, duke e çuar përpara analizën e studimit dhe duke thelluar fushat që shpesh ndërthuren në një fazë të mëvonshme në lidhje me qasjen e parë. Një shembull për ta ilustruar është kur është regjistruar një procedim penal dhe çështja është në proces ose kur kontakti me viktimën ndodh gjatë procesit gjyqësor apo gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në këtë fazë dalin në dritë çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin midis shumë agjencive në përgatitjen dhe realizimin e

intervistave si dhe në asistencën dhe mbrojtjen në favor të viktimës. Duhet të trajtohen pyetjet që kanë të bëjnë me teknikat e intervistimit dhe detyrimin për të shmangur një viktimizim të dytë të viktimës; duhet të përshkruhet metodologjia moderne për intervistimin e viktimës (shih për shembull modelin PEACE). Mund të riprodhohen gjithashtu skenaret për intervistat e prokurorit, seancave paraprake ose seancave gjyqësore, me pjesëmarrjen e palëve.



Metodologjia:

(sesione teorike - video - raste studimore - diskutime në grup në fund të seancës së trajnimit)

5.3 MODULI I TRETË



Hetimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe formave të rënda të shfrytëzimit (shih kapitullin 6)

Në këtë kontekst, duhet të theksohet roli thelbësor i hetimeve proaktive që nuk kushtëzohen nga denoncimi i viktimës apo deklaratimet e bëra nga viktima para organeve ligjzbatuese. Të gjitha çështjet mund t'i referohen së pari kuadrit ndërkombëtar, por më pas duhet të sillen në dimensionin e legjislacionit vendas në mënyrë që të jenë të disponueshme për gjyqtarët dhe prokurorët. Pse duhet që hetimet proaktive të zënë një vend qendror në Udhëzuesin për Trajnimin e Trajnerëve? A nuk mjafton të merret një kallëzim/deklarim/dëshmi nga viktima?

Trajnuesit duhet të theksojnë një përparësi kyçe në trajnimet për hetimin e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore: Prokurorët dhe gjyqtarët nuk

kanë nevojë të varen nga dëshmia e viktimës për të nisur dhe për të kryer hetime apo për të marrë vendime gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ka shumë mënyra dhe teknika të ndryshme për të marrë prova përveç dëshmisë së viktimës. Deklarimet e tyre mund të jenë një vlerë e shtuar e fortë por nuk duhet të jenë thelbësore për nisjen e një hetimi. Ato mund të përdoren si konfirmim i mëtejshëm i provave që janë mbledhur tashmë me mjete të ndryshme, në mënyrë proaktive. Për prokurorin, ato duhet të jenë prova shtesë që vijnë nga viktima e krimit. Për të kuptuar më mirë se si mund të hetohet trafikimi i qenieve njerëzore pa u mbështetur te dëshmia e viktimës mund të jepen shembuj konkretë ilustrues, bazuar në hetime dhe

procese gjyqësore (p.sh. nga Italia).


Hetimet duhet të bazohen në strategji dhe metoda hetimore komplekse duke u vënë theksi tek hetimet proaktive bazuar në format e ndryshme në të cilat shfaqet trafikimi i qenieve njerëzore, si një krim që shpesh kontrollohet nga grupet kriminale në nivel

kombëtar dhe ndërkombëtar.

Metodat janë të ndryshme duke përfshirë teknologjinë si dhe forma të tjera dinamike. Udhëzuesi për Trajnimin e Trajnerëve fokusohet në disa prej tyre.

a. Survejimi elektronik si një mënyrë invasive për të marrë prova nga çdo pajisje elektronike, për të përgjuar biseda apo çdo lloj komunikimi. Duke pasur parasysh natyrën e tij invasive, survejimi elektronik përgjithësisht i nënshtrohet një kontrolli të rreptë gjyqësor për të shmangur abuzimet. Prokurorët duhet të mbajnë gjithmonë parasysh se trafikantët në shumë raste i njohin teknikat e surveimit. Për këtë arsye, operacionet duhet të kryhen gjithmonë me profesionalizëm të lartë.

Prokurorët duhet të inkurajohen të mbledhin prova me anë të mënyrave të mëposhtme:



Në epokën digjitale, një horizont i ri hetimesh kundër trafikantëve përfaqësohet nga ndërhyrjet në internet ose kompjuter, apo përgjimeve nëpërmjet një pajisjeje të internetit. Trafikantët përdorin TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit) si taktikë për të rekrutuar, transferuar, drejtuar dhe shfrytëzuar viktimat si dhe për të shkëmbyer para në të gjithë botën. Kështu, veprimtaria kriminale e organizatave fuqizohet pasi kapaciteti i tyre kriminal rritet dhe ato marrin strukturën tipike të krimit të organizuar mafioz. Në të njëjtën kohë, për organet ligjzbatuese dhe prokurorët që luftojnë trafikimin, teknologjia e informacionit nuk duhet konsideruar domosdoshmërisht si një problem që lehtëson trafikimin por mund të përdoret si mjet për të rritur zbulimin e rasteve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.

Në këtë kontekst specifik do të ishte e dobishme të përfshihet në programin e trajnimit metodologjia inovative e kohëve të fundit për zbulimin online të rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Interneti dhe trafikimi i qenieve njerëzore janë të ndërlidhur. Shumë platforma të mediave sociale, aplikacione për lidhje romantike, dhe grupe private online po “merren peng” nga individë të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual apo për punë. Këta individë përpiqen të devijojnë vëmendjen e agjencive ligjzbatuese dhe të shmangin zbulimin prej tyre. Për këtë qëllim, është e domosdoshme të trajtohet se si prokuroria mund të rrisë monitorimin e platformave që mund të ofrojnë shërbime seksuale, rekrutim, fshehje ose transportim të viktimave të trafikimit.



SHEMBULL ILUSTRUES

Në muajin shtator të vitit 2022, EUROPOL organizoi një trajnim simulues ku u mbledhën bashkë ekspertë nga autoritete të ndryshme ligjzbatuese të BE-së me fokus në luftën kundër rrjeteve kriminale që përdorin mediat sociale, përdorimin e internetit dhe dark web për të realizuar trafikimin e qenieve njerëzore. Krahasuar me fusha të tjera të krimit si trafikimi i drogave apo trafikimi i armëve, identifikimi i indikatorëve të trafikimit të qenieve njerëzore është më sfidues në mjedisin online. Ky veprim i përbashkët mbledhi informacione për të përcaktuar këta indikatorë si pjesë e luftës kundër rrjeteve kriminale duke përdorur një mjedis online për rekrutimin dhe shfrytëzimin e personave më vulnerabël. Këto çështje mund të trajtohen nga një perspektivë trajnimi me anë të një trajnimi teknologjik të realizuar nga ekspertë, duke përdorur shembuj dhe metoda operimi konkrete.

b. Hetimet digjitale si platformë moderne pune

Evoluimi i hetimit digjital përfshin ndërhyrjen në kompjuter për të marrë, në mënyrë të ligjshme, çdo lloj informacioni që lidhet me raste trafikimi. Një virus (spyware) digjital është një program software që futet brenda sistemit operues të një pajisjeje digjitale (laptop, kompjuter, telefon smart, etj.) dhe është në gjendje ta marrë në zotërim atë sistem, të kontrollojë audio/videot, duke bërë kështu një përgjim klasik, por edhe të lokalizojë dhe gjurmtojë personin ose të marrë çdo lloj informacioni tjetër, dokumente, foto, informacion mbi navigimin në internet, e-mail ose mesazhe private në rrjetin social.

c. Hetimet shkencore

Hetimet shkencore karakterizohen nga zbatimi i metodës shkencore për të hulumtuar dhe vlerësuar provat. Pika e fortë e tyre gjendet te objektiviteti i tyre, pra nuk varen nga perceptimi dhe përfaqësimi subjektiv, që janë tipike në provat mbi bazë dëshmie. Prokurorët duhet të jenë të informuar në lidhje me aplikimin e hetimeve shkencore, si në botën fizike edhe në atë digjitale.

d. Hetimi paralel financiar

Prokurorët duhet të trajnohen që të shfrytëzojnë hetimin financiar. Një hetim i hershëm financiar ka për qëllim identifikimin e sasisë dhe vendndodhjes së aseteve kriminale të përfuara nga krimi. Që herët në hetim, duhen vendosur lidhje me njësitë e hetimit financiar,

për t'i bërë pjesë të hetimit të një rasti trafikimi. Një bashkëpunim i mirë midis policisë dhe prokurorisë që në nisje është shumë i rëndësishëm.

Kapaciteti i agjencive ligj zbatuese për identifikimin, hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale është po ashtu shumë i rëndësishëm për të ndryshuar perceptimin e zakonshëm se trafikimi i qenieve njerëzore është një krim me fitim të lartë/rrezik të ulët. Hetimet financiare nuk duhet të kufizohen vetëm te lëvizjet e parave dhe të aseteve nëpërmjet korporatave financiare, bankave dhe agjencive të tjera të transferimit të parave, por edhe nëpërmjet kanaleve jozyrtare. Përdorimi i sistemeve paralele (ose të paligjshme) të transferimit të parave është një prej teknikave më të vjetra për transferimin e parave dhe të shërbimeve nga njëri vend në tjetrin pa i lëvizur mallrat ose paratë, dhe është i përhapur në të gjithë botën.

e. Inspektimet e punës

Puna e detyruar është një shkelje e të drejtave të njeriut, duke prekur bazën ekonomike të shoqërive moderne në të gjithë botën. Prokurorët duhet të jenë të trajnuar siç duhet për identifikimin e këtyre rasteve dhe për ndjekjen penale të autorëve. Meqenëse trafikimi i qenieve njerëzore për qëllimin e shfrytëzimit për punë është më pak i monitoruar dhe më i vështirë për t'u zbuluar në krahasim me shfrytëzimin seksual, është e rëndësishme që të sigurohet përfshirja e inspektorëve të punës, për të bashkëpunuar në një kontekst ndërsektorial. Ndonëse inspektorët e punës kanë detyra të ndryshme nga ato të oficerëve të policisë, është shumë e rëndësishme që të ketë një koordinim me aktivitetin e tyre, për të përfituar nga profesionalizmi i tyre, në kontekstin e një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Nën dritën e rëndësisë që ka kjo çështje, do të ishte me vend të përgatiteshin trajnime me një referim në çështje konkrete (si p.sh. vendimi i GJEDNJ i 2017, Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë; apo vendimi i GJEDNJ i 2022, Zoletic dhe të tjerë k. Azerbajxhanit) që përmbajnë aspektet më të rëndësishme të mbrojtjes së viktimave të shfrytëzimit për punë si dhe efektshmërinë e luftës kundër autorëve. Mbi bazën e këtyre vendimeve gjyqësore (dhe shumë të tjerave nga GJEDNJ-ja) mund të ndërtohen raste studimore specifike, duke u nisur nga një çështje e përgjithshme e vendosur nga GJEDNJ e duke e përshtatur atë në kontekstin shqiptar.

f. Ndihma e ndërsjelltë juridike

Si Protokollin e Palermos ashtu edhe Konventa për Masat kundër Trafikimit të Këshillit të Evropës parashikojnë që Shtetet Palë të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, në masën më të madhe të mundshme, për qëllimet e parandalimit të trafikimit, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të trafikantëve. Në kuadër të Këshillit të Evropës, Relacioni Shpjegues i Konventës sqaron se dispozitat për bashkëpunimin ndërkombëtar nuk kufizohen tek bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale, por përfshijnë bashkëpunimin për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e viktimës dhe ndihmën e ndërsjelltë. Këto lloj bashkëpunimesh plotësojnë njëra-tjetrën për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve. Shtetet duhet të

sigurojnë bashkëpunim për hetimet dhe proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me trafikimin dhe vepra penale që lidhen me të. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë, ndër të tjera, asistencë për identifikimin dhe intervistimin e dëshmitarëve si edhe identifikimin, marrjen dhe ruajtjen e provave.

Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor është me rëndësi kyçe duke pasur parasysh natyrën ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore, si nëpërmjet flukseve migratore ashtu edhe brenda kufijve të vendit. Ndër vite janë zbatuar instrumente të reja të ndihmës së ndërsjellë juridike me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit si një formë dialogu e drejtpërdrejtë midis prokurorëve, duke nisur që nga Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale e vitit 1959.

Në kontekstin e Bashkimit Evropian, roli i EUROJUST merr rëndësi parësore për ndihmën e prokurorëve në shtetet anëtare, duke u dhënë atyre mbështetje për organizimin e takimeve koordinuese dhe qendrave të koordinimit, për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave si edhe për ngritjen dhe financimin e ekipeve të përbashkëta hetimore. EUROJUST bashkëpunon edhe me shtete të treta jashtë BE-së, duke e zgjeruar kështu rrjetin e bashkëpunimit.

Bashkimi Evropian ka prezantuar së fundmi një instrument tejet të vlefshëm ligjor për bashkëpunimin gjyqësor që njihet si Urdhri Investigativ Evropian. Kjo risi ka të bëjë me parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore, një parim që është baza e një sërë direktivave të BE-së, përfshirë atë për Urdhërarrestin Evropian dhe është në përputhje me efektshmërinë që frymëzon Konventën e BE-së për Asistencë të Ndërsjellë në Çështje Penale, që plotëson Konventën e Këshillit të Evropës për Asistencë të Ndërsjellë në Çështje Penale të 1959 dhe Protokollin e saj të 1978.


Një instrument tjetër që mund të përdoret me efikasitet, aty ku është e mundur, lidhet me ekipet e përbashkëta hetimore (EPH/JIT).

Për të gjitha këto tema në lidhje me aspekte të ndryshme të ndihmës së ndërsjellë juridike, prokurorët duhet të përgatiten të ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me kolegë nga vende të tjera.



Metodologjia:

(sesione teorike - video - raste studimore - diskutime në grup në fund të seancës së trajnimit)



6. USHTRIMET E BAZUARA NË SIMULIM (mundësi që ofron fleksibilitet)

Në tetor 2021, në Shqipëri u organizua me sukses nga Prezenca e OSBE-së një ushtrim i bazuar në simulim.¹ Metodologjia e trajnimit të këtij simulimi mund të ndryshohet dhe të përshtatet sipas nevojave specifike. Në çdo rast, ushtrimet e bazuara në simulim duhet të përfshijnë inskenimin e situatave të jetës reale. Kjo u mundëson pjesëmarrësve në trajnim që të realizojnë vendimmarrje në një mjedis të sigurt, pa qenë nevoja të shqetësohen për pasojat e vendimeve të tyre. Si metodë që në fokus ka nxënësin/pjesëmarrësin, këta të fundit vendosen

në qendër të procesit të nxënies (përkundrejt vetë trajnuesit). Në dallim nga leksionet në klasë, trajnuesit ndërveprojnë me pjesëmarrësit më shumë në rolin e një lehtësuesi. Gjatë këtij lloji ushtrimi, pjesëmarrësit në trajnim marrin pjesë në raste të simuluar të trafikimit të qenieve njerëzore që rikrijohen me aktorë. Pjesëmarrësve u kërkohet të reagojnë ndaj disa ngjarjeve në skenar (“inpute”), të merren me detyra konkrete, të nxjerrin kuptimin e një sekuence ngjarjesh, të rindërtojnë historinë e rastit si dhe të përpunojnë të dhëna hetimore.



¹ Për t'u njohur me planifikimin dhe organizimin e ushtrimit simulues, referojuni Manualit të OSBE-së "Trajnimi Simulues Për Identifikimin, Referimin dhe Mbrojtjen e Viktimave dhe Hetimin Proaktiv të Trafikimit të Qenieve Njerëzore", 2022. https://www.osce.org/files/f/documents/2/d/513898_0.pdf

Përfitime shtesë të ushtrimeve shumëdisiplinore simuluese

Me anë të ushtrimeve simuluese që pasqyrojnë një situatë me vërtetësi, pjesëmarrësit në trajnim kanë mundësinë të përvetësojnë parimet e anti-trafikut në praktikë, parime që nuk trajtohen posaçërisht në trajnime standarde. Këto parime mund të përfshijnë dhënien e asistencës për viktimat, pavarësisht nëse bashkëpunojnë apo jo me sistemin e drejtësisë penale; rëndësinë e mediatorëve kulturorë për të lehtësuar komunikimin me viktimat; bashkëpunimin efikas me organizatat e shoqërisë civile; plotësimin e nevojave të posaçme për viktimat e mitura; si dhe trajtimin e kryqëzimit të legjislacionit për migracionin, mbrojtjen ndërkombëtare dhe atij të anti-trafikut.

Për të zbatuar me sukses hapat e kërkuar, duhet të ketë komunikim dhe bashkërendim midis ekipeve dhe disiplinave të ndryshme. Nëse nuk e bëjnë këtë, nuk do t'i arrijnë objektivat. Trajnimi i bazuar në simulim bën të mundur që pjesëmarrësit të mësojnë duke qenë të përfshirë direkt në situata konkrete, si edhe duke mësuar nga pjesëtarët e tjerë kolegë të së njëjtës fushë apo edhe të profesioneve të tjera. Gjatë përpjekjeve për të gjetur zgjidhje për problemet apo për të vendosur linjën e veprimit, pjesëmarrësit në trajnim përballen me këndvështrime apo metoda pune të ndryshme si brenda fushës së tyre të ekspertizës ashtu edhe përtej saj. Në fund të ditës, trajnuesi ekspert për secilën fushë udhëheq diskutimet përmbledhëse në ekipin e tij/saj dhe i udhëzon pjesëmarrësit që të reflektojnë në lidhje me objektivat që janë arritur dhe çfarë mund të përmirësohet. Kjo metodë mundëson të mësuarin e avancuar dhe të specializuar për një gamë të gjerë profesionistësh (përfshirë edhe për mënyrën se si roli i tyre mund të përshtatet në tablonë e madhe të masave anti-trafikim në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, si dhe mënyrën se si komunikimi dhe bashkëpunimi bëjnë ndryshimin në arritjen e rezultateve në jetën reale). Gjatë një ushtrimi, ekipet nga disiplina të veçanta duhet të ndërveprojnë me ekipe të tjera (p.sh. inspektorët e punës ndërveprojnë me ligjzbatuesit), duke konkretizuar veprimin me masa ndërsektoriale. Në fund të çdo dite trajnimi, të gjitha ekipet bëjnë diskutime në grup për të reflektuar mbi veprimet e ditës brenda secilit ekip profesionistësh, dhe më pas diskutojnë në grup të madh vështirësitë e hasura si dhe zgjidhjet. Trajnimi i bazuar tek simulimi është një metodë e vlefshme që i ndihmon profesionistët të kapërcejnë pengesa praktike në punën e përditshme në lidhje me trafikimin.

Përmbledhtazi, qasja që përfshin shumë disiplina mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë ndërthurjen funksionale midis fushave të ndryshme që takohen në çështjet e trafikimit. Ushtrimet simuluese janë një mënyrë e fuqishme për të ndërtuar një rrjet të gjerë e praktik të profesionistëve anti-trafikim në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Në këtë ushtrim intensiv, pjesëmarrësit kanë mundësinë të vendosin lidhje profesionale dhe personale me pjesëmarrës të tjerë. Vetë formati forcon një nivel angazhimi që shkon përtej mundësive të një leksioni normal apo një ore mësimi në klasë.

Trajnimi simulues bazohet në parimet e të mësuarit nga përvoja. Kur përdoren ushtrimet simuluese për qëllime mësimi, është e nevojshme të mbahet parasysh i gjithë cikli i të mësuarit dhe të hartohet një trajnim duke i kushtuar vëmendje të gjitha fazave të procesit. Qasja e të mësuarit nga përvoja paraqitet në një cikël me katër faza nëpër të cilat kalon pjesëmarrësi: Përvoja, reflektimi, përgjithësimi, dhe zbatimi në kontekste reale.

Përvoja	Të krijosh/kesh një përvojë
Reflektimi	Shqyrtimi/Reflektimi për përvojën
Përgjithësimi	Përfundime/mësime nga përvoja
Zbatimi	Planifikimi/mësimi në një kontekst real

Në trajnimet simuluese të OSBE-së, që në fillim të procesit, pjesëmarrësit në trajnim zbulojnë informacionin që kërkon një reagim nga ana e tyre për të identifikuar, referuar apo asistuar një viktimë të mundshme trafikimi.

Përvoja

Mekanizmi i simulimit aktivizohet nga aktorët, të cilët luajnë rolin e personazheve të rastit/rasteve konkrete, si edhe nga inputet që japin trajnerët për të inkurajuar apo për të korrigjuar veprimet e pjesëmarrësve gjatë trajnimit simulues. Pjesëmarrësit në trajnim përballen me një mori detyrash dhe situatash. Ata duhet të analizojnë situatën dhe të vendosin se çfarë do të bëjnë dhe se si do ta bëjnë punën. Me zhvillimin e ngjarjeve, ekipet e ndryshme duhet të ndërmarrin veprime, të komunikojnë, të hetojnë, dhe të përshtatin planet në varësi të elementeve të reja që zbulohen. Kështu, identifikohen viktimat, hetohen trafikantët e dyshuar, realizohen veprimet për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimat, etj. Kjo pjesë e procesit njihet si “eksperiencia” e trajnimit të bazuar te simulimi.

Reflektimi

Duke qenë se trajnimet simuluese të OSBE-së i vendosin pjesëmarrësit në skenarë kompleksë, është e rëndësishme që vetë pjesëmarrësit, së bashku me ekspertët/trajnesit që drejojnë këtë ushtrim, të kenë mundësi që të reflektojnë periodikisht mbi atë që po ndodh gjatë këtij trajnimi. Fazat e reflektimit janë shumë të rëndësishme për përpunimin e informacionit, duke qenë se u mundësojnë si pjesëmarrësve ashtu edhe trajnesve të shkëmbejnë këndvështrimet dhe të analizojnë atë që ka ndodhur. Pikërisht në këtë pikë fillon procesi i nxënies.

Reflektimi mund të ndodhë edhe gjatë zhvillimit të trajnimit. Megjithatë, në mënyrë që procesi i nxënies të jetë i efektshëm, është e rëndësishme që të zhvillohen diskutime vlerësuese, sistematike, në grup, ku pjesëmarrësit të jenë aktivë.

Përgjithësimi

Pas analizës së “asaj që ka ndodhur” gjatë eksperiencës me anë të reflektimit, pjesëmarrësit në trajnim janë gati të shtjellojnë më tej mësimet që kanë marrë gjatë trajnimit simulues si edhe të arrijnë në përfundime. Kjo fazë u mundëson pjesëmarrësve të shprehin dhe të përvetësojnë atë që kanë mësuar.

Vërtetësia në trajnime/ushtrime simuluese

Një çështje për kujdes të veçantë: vërtetësia në simulim është një element i fuqishëm. Megjithatë, vërtetësia nuk është i vetmi element i rëndësishëm për të mësuarit gjatë një ushtrimi simulimi. Është e rëndësishme që trajnuesit të mos mbështeten më shumë se duhet tek vërtetësia në dëm të hapave të tjerë metodologjikë që lehtësojnë procesin e nxënies. Ndonëse elementet e vërtetësisë që janë pjesë e simulimeve luajnë një rol kyç në angazhimin dhe motivimin e pjesëmarrësve e mund ta bëjnë këtë përvojë shumë të gjallë, procesi i nxënies varet edhe nga fakti se sa me efektivitet zbatohen të gjitha fazat e nxënies, përfshirë reflektimin, përgjithësimin dhe zbatimin, brenda kuadrit të trajnimit simulues.

Mbështetur në aktivitetin e përmendur më lart, është publikuar një doracak simulimi në shqip; ai është përshtatur sipas rrethanave dhe kontekstit shqiptar dhe mund të gjendet në https://www.osce.org/files/f/documents/2/d/513898_0.pdf.

Një variant i mundshëm i simulimit, me përmasa më të vogla, por i ngjashëm për sa i takon parimit mësojmë-duke-vepruar në proces, është trajnimi si gjyq imitues, i lidhur me faza specifike gjykimi, të cilat duhet të merren në konsideratë për disa çështje të rëndësishme (p.sh. pyetja e viktimës dhe dëshmitarëve në seancë, me pjesëmarrjen e të paktën gjykatësit, prokurorit, dhe avokatëve).



6.1 OBJEKTIVA SPECIFIKE PËR PROKURORËT

Trajnimi/ushtrimi simulues nuk është një format i ngurtë, por fleksibël e që mund të përshtatet sipas interesave kryesore të grupeve profesioniste të ndryshme të përfshira. Përfitimet mund të vlerësohen si për agjencitë e përfshira ashtu edhe për kategoritë individuale të profesionistëve.

Në lidhje me prokurorët, objektivat e trajnimit janë përgjithësisht të shumëfishta dhe komplekse, në linjë me dimensionin ndërsektorial të hetimeve të

trafikimit të qenieve njerëzore si edhe me rolin e prokurorit që njërin sy e ka te faza e hetimit dhe tjetrin tek procesi i mundshëm gjyqësor.

Më poshtë jepet një listë me objektivat e mundshme për mësimet që mund të nxirren, duke theksuar se kuadri dhe prioritetet kombëtare janë ato që përcaktojnë renditjen e përparësive që duhet të mbahen parasysh në praktikë:

- *Duhet pasur një vizion i përgjithshëm për hetimin e çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe vepra të tjera të lidhura me të;*
- *Duhet siguruar që secili element i veprës penale të hetohet dhe të analizohet me anë të ushtrimit simulues (për trafikimin e qenieve njerëzore, p.sh. veprimet, mjetet, qëllimet, lidhjet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare, aspekte të migrimit, transaksione financiare, referenca për njerëz të tjerë të përfshirë, viktimat, trafikantë, ose dëshmitarë të thjeshtë, etj.);*

- Duhet siguruar që zhvillimi i aktiviteteve të hetimit të veprës penale të jetë në përputhje me natyrën komplekse të krimit; kjo do të jetë garanci për të shmangur kualifikimin jo të duhur ligjor të veprës penale në kategori më pak të rënda ose keqinterpretimin e fakteve;
- Duhet vendosur një vëzhgues për skuadrën e policisë në trajnim; të inkurajohet dhe nxitet hetimi proaktiv dhe - nëse është e nevojshme - përfshirja e njëkohshme e përfaqësuesve nga institucione të ndryshme;
- Duhet vendosur një drejtues (lider) në skuadrën e prokurorisë që të funksionojë si një pikë referimi për: a) skuadrën e policisë në lidhje me udhëzimet dhe planin hetimor; b) skuadrat e ndihmës humanitare që kanë prirjen të besojnë se Prokurori është i përfshirë edhe në mbrojtjen e të drejtave të viktimës;
- Duhet të bëhen përgatitjet e nevojshme për veprimin hetimor përkatës (p.sh. intervistimi i viktimës) dhe për ta realizuar atë në përputhje me kriteret ose modelin e përcaktuar që më parë (mos improvizoni);
- Duhet siguruar që intervistimi i viktimave bëhet në respektim të plotë me të drejtat e tyre të njeriut, pa asnjë situatë që mund të sjellë rrezikun e viktimizimit për së dyti;
- Gjatë zbatimit të veprimit hetimor (p.sh. intervistimi i viktimës) duhet treguar kujdes për aspektet procedurale në lidhje me provat nga këndvështrimi i vlefshmërisë së tyre në një proces gjyqësor në të ardhmen, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Penale;
- Duhet konsideruar të gjitha çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve ose kategori të tjera specifike vulnerabël;
- Duhet theksuar puna në ekip (dhe udhëheqja e punës në ekip) duke pasur parasysh natyrën shumëdimensionale të trafikimit të qenieve njerëzore (p.sh. për intervistimin e të miturve).

Lista nuk është shteruese dhe rast pas rasti mund të sugjerohen prioritete të tjera ose mund të ndryshohen disa nga këto që janë.

Simulimi mund të përshtatet e përdoret për trajnime të ndryshme, sipas nivelit të njohurisë së pjesëmarrësve në trajnim, sipas sfidave dhe formave të ndryshme të shfrytëzimit. Për shembull, një prokuror i pa specializuar mund “të vendoset në provë” në një mënyrë të ndryshme në

raport me një prokuror të specializuar i përfshirë në trajnim të vazhdueshëm. Në fund të ushtrimit simulues (Përvojës) nevojiten seanca Reflektimi dhe Përgjithësimi për t'i përgatitur pjesëmarrësit në trajnim për një Zbatim më të mirë në realitet. Në përfundim, këto udhëzime mund të pasurohen në të ardhmen me propozime më tej, në bazë të sugjerimeve nga ekspertë vendas, akademikë si edhe Prezenca së OSBE-së në Shqipëri.



SHTOJCA 1

Shembull i skenarit të një Ushtrimi Simulues

Veprimi X

Intervista me dy vajza të reja, viktimat të mundshme të trafikimit, organizuar me përfaqësues nga disa institucione.

Vendndodhja: një vend fiktiv ku viktimat ndihen të pashqetësuar, dhe që nuk është në një komisariat policor

Orari: 09.00 – 10.30

Skenari

Në një vend komod dhe në praninë e prokurorit, Sara dhe Meri intervistohen me imtësi nga një ekip me përfaqësues nga institucione të tjera.

Meri, në bazë të mënyrës se si flet dhe të shprehjeve që përdor, duket të jetë e mitur. Avokati ose psikologu duhet të kërkojë që intervistimi të kryhet në praninë e kujdestarit ligjor të të miturës, pasi është siguruar se ky vendim i shërben interesit më të lartë të të miturës.

Në dy vende të ndryshme neutrale dhe në praninë e prokurorëve, Sara dhe Meri intervistohen me imtësi nga ekipi me përfaqësues nga shumë agjenci, që është thirrur nga policia me miratimin e prokurorit.

Në fillim, Meri dhe Sara japin gjeneralitetet (emrin, mbiemrin, moshën, shtetësinë, statusin social në vendin e origjinës, nivelin e arsimimit), por Meri thotë se është 20 vjeçe (kur moshja e saj e vërtetë është 17).

Më pas të dyja rrëfejnë historinë e tyre të plotë dhe të vërtetë si dhe arsyen pse dhe mënyrën si kishin ardhur nga vendi Poorland, në bazë të historisë së tyre (që u është dhënë veçmas aktorëve) në sa më shumë detaje që mundën, dhe në gjendjen dramatike të dikujt që më në fund ka hedhur tej një barrë të rëndë gënjeshtresh.

Historia që tregojnë ato do të duhet të mbulojë të paktën si më poshtë:

U rekrutuan nga një burrë dhe një grua me emrat X and Y në vendin Poorland me premtimin e rremë ose me detyrimin për të shlyer një borxh;

Kanë udhëtuar me migrantë të tjerë që ikin nga vendi Warland dhe duke kaluar nëpër shumë vende arritën në destinacion në vendin Transiland, ku disa prej tyre u vendosën në një qendër të mbyllur për migrantë për kohësisht dhe u detyruan të prostituonin. Vendi Transiland ishte një zonë e ndërmjetshme dhe tranzit deri sa të mbërrinin në vendin ky synonin të emigronin, vendi Dreamland, vendi final ku donin të shkonin.

Ato u nisën për në vendin Dreamland, por motra e Sarës, R, mbeti në vendin Transiland. së bashku me gra të tjera të të njëjtit grup;

Gjatë udhëtimit në Transiland, grupi i tyre u ndal nja-dy herë nga disa burra të armatosur, por pa uniformë: shoferi i tyre u tregoi disa dokumente dhe ata i lejuan të kalonin në të gjitha rastet. Ajo vuri re se emigrantë të tjerë nga grupi duhej të paguanin;

Atyre u ishte thënë se me të arritur në vendin

Dreamland dhe pasi të ishin identifikuar së bashku me migrantë të tjerë, duhet të bënin kërkesë për marrjen e statusit të refugjatit si dhe leje qëndrimi të përkohshme;

Ato u transferuan në një qendër pritjeje për azilkërkesit. Ato u detyruan për prostitucion nën kontrollin e J ndërkohë që ishin të strehuara në qendër; U duhej të shlyenin borxhin ndaj organizatës kriminale për detyrimet e krijuara në Poorland, ato të rrugës për në Dreamland, dhe për punën e gjetur dhe për shpenzime të tjera si për veshje pune, telefon celular, etj.;

Disa prej vajzave të tjera u larguan pasi mbërritën së bashku në qytetin Zakontia dhe më pas mbërritën në qytetin Stareta sipas udhëzimeve të organizatës kriminale. Të dyja vajzat do të thonë se nuk e dinë arsyen e këtij transferimi, dhe do të hamendësojnë se të gjitha vajzat që u transferuan ishin nga e njëjta zonë (perëndimore) e vendit Poorland;

Përveç kësaj, në veçanti:

Sara do të tregojë se u abuzua seksualisht nga P (i dashuri i J) si pasojë mbeti shtatzënë dhe u detyrua nga vetë P të abortojë. Ai i tha se ajo do të duhej të fillonte të fitonte para sa më shpejt të ishte e mundur për t'ia kthyer. Ajo do të tregojë edhe për të motrën, R, që mbeti në vendin Poorland, së bashku me vajza e gra të tjera të të njëjtit grup; do të tregojë vullnetin për të bashkëpunuar sepse dëshiron që organizata

kriminale të shkatërrohet me qëllim që të lirohet R dhe familja e saj nga borxhi që i detyrohen organizatës kriminale.

Meri do të kërkojë të intervistohet nga një grua dhe tregon për kushërirën e saj O dhe do t'i tregojë ekipit një foto të saj. Ajo do të tregojë historinë si u shënjestrua si pjesëtare e një grupi minoritar dhe për nevojën e saj për mbrojtje për të dhe për kushërirën në rast se familja ose komuniteti i saj e zbulojnë fatin e tyre në vendin D.

Të gjitha deklaratimet bashkëpunuese të dhëna nga viktimat varen nga realizimi korrekt të i intervistës nga ana e intervistuesit. Aktorët janë udhëzuar për këtë gjë.

Gjatë dhe në fund të intervistave, nëse ekipi me përfaqësues nga disa institucione do të ketë qasjen e duhur (p.sh. për Merin, ta qetësojnë edhe për frikën që ka se familja mund të informohet për punën që bën si prostitutë dhe për Sarën që organizata kriminale do të çmontohet së shpejti, dhe se motra e saj R do të lirohet falë edhe ndihmës që ato po japin), dy vajzat e reja pranojnë të marrin pjesë në programin e mbrojtjes dhe asistencës duke nisur periudhën e rimëkëmbjes dhe reflektimit, që përfshin edhe akomodimin në një vend të sigurt.

Ato çohen në një strehëz dhe mund të fillojnë fazat e ndryshme, nëse janë parashikuar.

AKTIVITETE TË PRITSHME

- Në një vend neutral dhe komod si dhe në praninë e prokurorit, intervistohen Sara dhe Meri.
- Vendimi për intervistimin paraprihet nga një mbledhje e profesionistëve të ndryshëm që drejtohet nga prokurori.

ÇFARË PRITET, OSE MUNDËSISHT DO TË INJEKTOHET NË USHTRIM

- Avokatët u kërkojnë prokurorëve t'i kërkojnë gjyqtarit të caktojë një kujdestar ligjor për Merin.
- Përgatiten mirë intervistat (mundësisht duke zbatuar modele të miratuara, si p.sh. modeli PEACE).
- Intervistat zhvillohen duke përdorur qasjen me përfshirjen e disa institucioneve dhe me mbështetjen e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve për të dyshuarën si e mitur.
- Intervistat zhvillohen me qasje mbi bazë gjinore dhe të të drejtave të njeriut, duke shmangur çdo formë të viktimizimit për së dyti. I gjithë informacioni i nevojshëm duhet t'u jepet personave që në fillim.
- Në fund të intervistave, dy vajzave u ofrohet të marrin pjesë në një program për mbrojtje dhe asistencë. Nëse pranojnë, çohen në një strehëz dhe mund të vijojnë fazat e tjera.

Pjesëmarrësit në trajnim mund të orientohen me anë të injektiveve, një lloj inputi që u jepet nga jashtë nga trajnuesit, që të fillojnë aktivitetin e simuluar.

Trajnuesit, duke qëndruar jashtë skenës, me ndihmën e antenave (vëzhgues të heshtur që vetëm shohin veprimet) monitorojnë simulimin, ndërhyjnë nëse është e nevojshme me injektive dhe marrin shënime për hapat e mëtejshëm (diskutime vlerësuese në secilin grup dhe diskutime në grupin e madh).

Këto injektive dërgohen nga trajnuesit për të nxitur rolin e agjencive dhe profesionistëve (p.sh. drejtuesi i ekipit të prokurorisë, drejtuesi i ekipit të policisë, drejtuesi i strehëzës, ...). Injektimet mund të jenë të zakonshme (për t'i nxitur pjesëmarrësit të lëvizin drejt një aktiviteti specifik) ose korrigjuese (për të korrigjuar gabime që po bëjnë pjesëmarrësit në trajnim).

OBJEKTIVAT PËR ÇFARË DO TË MËSOHET (disa)

- Kontaktimi dhe përfshirja e OJF/Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe kërkesa për ndihmën e përkthyesve dhe ndërmjetësve kulturorë profesionistë dhe/ose mbështetje psikologjike për zhvillimin e intervistave individuale me viktimat e mundshme të trafikimit.
- Shmangia e riviktimizimit të mundshëm të viktimës.
- Të siguruarit që asistencë dhe mbrojtja e viktimave nuk varet nga gatishmëria e tyre për të bashkëpunuar me agjencitë ligjzbatuese dhe nuk varet nga statusi i tyre i qëndrimit në vend (nëse janë migrantë).
- Dhënia e këshillimit, asistencës ligjore, sociale dhe mjekësore si dhe mbështetje për viktimat. Informimi i viktimës siç duhet edhe sa duhet për të drejtat e tyre.
- Përshtatja e asistencës në mënyrë specifike sipas gjinisë dhe nevojave individuale.
- Realizimi i duhur i vlerësimit nëse viktimat e mundshme të trafikimit është person i mitur dhe marrja e masave në vijim.
- Veprimi i prokurorëve dhe avokatëve në koordinim me oficerët që kryejnë hetimin duke u dhënë atyre mbështetje dhe anasjelltas.
- Fitimi i besimit të viktimave të trafikimit, duke i garantuar për sigurinë e tyre dhe të familjes së tyre dhe se e ardhmja është në përputhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut,

dhe njëkohësisht ndihmesa e viktimave për bashkëpunim të mundshëm me prokurorin dhe oficerët e policisë.

- Besimi i pjesëmarrësve profesionistë (prokurori, oficeri i policisë, punonjësit socialë,...) ndaj njëri-tjetrit dhe përfitimi nga vlera e shtuar e bashkëpunimit të ndërsjellë).

Kërkesat për simulimin:

AKTORË	MATERIALE	PJESËMARRËSIT NË TRAJNIM
Sara	laptop	Prokurorët
Meri	regjistrime audio-video	Oficerë policie
		Punonjës socialë
		Punonjës të kujdesit të fëmijëve
		Përkthyes
		Avokatë/Psikologë

DOKUMENTE (të gjitha dokumentet e parashikuara në skenar)

p.sh. foto Dokumente ID ose formularë tip, si për shembull:

Formulari i intervistës fillestare
Formulari i intervistës formale
Formulari i referimit të rastit
Formulari i treguesve të trafikimit të qenieve njerëzore
Fletëpalosje në gjuhë të ndryshme në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit dhe mundësive për mbështetje
Përmbledhje e programit të asistencës dhe mbrojtjes
Formulari i pëlqimit të informuar

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Mancini, David

Udhëzues : për trajnimin e trajnerëve mbi trafikimin
e qenieve njerëzore : për gjyqtarë dhe prokurorë /
David Mancini ; përkth. Gentjan Suli ; red. Evis
Alimehmeti, Juliana Rexha. -

Tiranë : Kumi, 2023.

... f. ; ... cm

ISBN 9789928340863

1. E drejta penale 2.Trafikimi i qenieve njerëzore
3. Të drejtat e njeriut 4.Manuale

343.54 (035)



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

ISBN 9789928340863



9 789928 340863